

VENDIM
Nr. 103, datë 4.2. 2015

PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË
INSPEKTORATIT SHETËTËROR TË MJEDISIT DHE PYJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 e 51, pika 3, të ligjit nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRIJIMI I INSPEKTORATIT SHETËTËROR TË MJEDISIT DHE PYJEVE

1. Krijohet Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (në vijim “ISHMP”) si institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin.

2. Ministria përgjegjëse për mjedisin mbështet funksionimin efektiv të ISHMP-së. Në këtë përgjegjësi nuk përfshihet drejtimi operacional i veprimtarisë së inspektimit.

II. MISIONI DHE FUNKSIONET E ISHMP-së

1. ISHMP-ja ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe pyjeve.

2. ISHMP-ja është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën përkatëse, në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2, të këtij kreu, ISHMP-ja është përgjegjëse për çdo funksion apo kompetencë tjetër, të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për inspektoratin shtetëror, që mbulon fushën e mjedisit.

4. ISHMP-ja ushtron juridiksionin e vet territorial në të gjithë territorin e vendit.

III. MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE E FUNKSIONIMIT TË ISHMP-së

1. ISHMP-ja organizohet në dy nivele: në nivelin qendror dhe atë rajonal, ku këto të fundit ngrihen për çdo rajon të vendit.

2. ISHMP-ja drejtohet nga kryeinspektori, i cili është titullari i institucionit.

3. Në kuadër të funksioneve dhe detyrave të ISHMP-së, kryeinspektori ushtron këto kompetenca:

a) përfaqëson inspektoratin në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin dhe bashkërendimin e punës për funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së këtij inspektorati;

b) zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të ISHMP-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit përgjegjës;

c) nxjerr urdhra për mbarëvajtjen e vazhdueshme të punës, për përcaktimin e procedurave, kompetencave, detyrave dhe funksioneve për kryerjen e veprimtarive inspektuese të strukturave të ISHMP-së, në nivel qendror dhe rajonal, në fushën e inspektimit të mjedisit dhe pyjeve;

ç) bashkërendon veprimtarinë e ISHMP-së me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën e inspektimit të mjedisit dhe pyjeve;

d) siguron kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme të huaja për zgjidhjen efektive të problemeve në fushën e inspektimit të mjedisit dhe pyjeve, si dhe kryen veprimtari të tjera për plotësimin e detyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin në këtë fushë;

dh) siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit dhe pyjeve;

e) ushtron çdo funksion tjetër, të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

4. Kryeinspektori i ISHMP-së i raporton drejtpërdrejt ministrit përgjegjës për mjedisin, përveçse kur ministri ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi në aparat in e ministrisë përgjegjëse.

5. ISHMP-ja në nivel qendror ka këto funksione:

- a) planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit;
- b) siguron unifikimin e praktikave të inspektimit në shkallë vendi;
- c) bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të vet dhe siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të tjerë të akredituar, në rastin e pamundësisë së kryerjes së tyre nga laboratorët e vet;
- ç) informon publikun për veprimtarinë e inspektimit;
- d) jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore për veprimtarinë e inspektimit;
- dh) përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit.

6. Përveç sa parashikohet në pikën 5, të këtij kreu, ISHMP-ja në nivel qendror është përgjegjëse për të gjithë institucionin, përfshirë edhe degët në nivel rajonal, për kryerjen e këtyre funksioneve të brendshme:

a) menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe ndjekjen e çështjeve ligjore, të teknologjisë së informacionit, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve të tjera mbështetëse;

b) përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e auditimit të brendshëm.

7. Pranë ISHMP-së në nivel qendror krijohet “Komisioni i ankimit të ISHMP-së”, i cili drejtohet nga kryeinspektori dhe ka në përbërje të tij:

- drejtorin përgjegjës për inspektimin e mjedisit;
- drejtorin përgjegjës për inspektimin e pyjeve;
- drejtorin përgjegjës për shërbimet mbështetëse;
- juristin e institucionit.

8. Komisioni i ankimit të ISHMP-së kryen këto detyra:

a) Mblidhet për të shqyrtuar ligjshmërinë e aktit ndaj të cilit është bërë ankim/kërkesë administrative dhe merr vendimin, në respektim të procedurës dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative;

b) Në të gjitha rastet kur komisioni vlerëson pranimin e ankesës/kërkesës për shfuqizimin e vendimit administrativ, me kërkesë të komisionit, në mbledhje duhet të jetë i pranishëm autoriteti përkatës, i cili ka marrë vendimin;

c) Për çdo vendim, komisioni njofton me shkrim, zyrtarisht, subjektin ankues/kërkues;

ç) Ushtron funksionet, në përputhje me afatet dhe procedurat e ankimeve, të parashikuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në Kodin e Procedurave Administrative, në ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, dhe rregulloren përkatëse të funksionimit, të miratuar nga komisioni.

9. Degët rajonale të ISHMP-së ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin në atë qark.

Me urdhër të kryeinspektorit, inspektorët e një dege rajonale mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe në territorin e një qarku tjetër, në bashkëpunim me degën rajonale përkatëse.

10. Degët rajonale, të cilat kanë në territorin e tyre pika të kalimit të kufirit, bashkëpunojnë me organet doganore dhe organet e tjera përkatëse për parandalimin e dëmtimit të cilësisë së mjedisit apo të përbërësve të tij të veçantë.

11. Degët rajonale të ISHMP-së drejtohen nga drejtuesi i degës rajonale. Drejtuesi i degës rajonale përfaqëson degën rajonale në marrëdhënie me të tretët, në nivelin e qarkut përkatës, dhe është përgjegjës për organizimin dhe bashkërendimin e punës për funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së degës së tij.

12. Përveç sa parashikohet në pikën 11, të këtij kreu, drejtuesi i degës rajonale:

- a) jep autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit;

b) vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së autorizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin, dhe për zëvendësimin e inspektorëve gjatë inspektimit, me përjashtim të rasteve kur urdhërohet nga kryeinspektori qendror.

13. Drejtuesi i degës rajonale i përgjigjet dhe raporton drejtpërsëdrejti te kryeinspektori i ISHMP-së, përveçse kur kryeinspektori ka caktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi pranë ISHMP-së në nivel qendror.

IV. STEMA DHE VULA ZYRTARE E ISHMP-së

1. ISHMP-ja identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

2. Stema e ISHMP-së përbëhet nga stema e Republikës dhe emërtimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve”.

3. Vula e ISHMP-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula e ISHMP-së në nivel qendror përmban edhe shënimin identifikues “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve”, ndërsa vulat e degëve rajonale përmbajnë shënimin identifikues “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Dega Rajonale e Qarkut (emri i qarkut përkatës)”.

4. Vula e ISHMP-së dhe vulat e degëve rajonale prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

V. DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohet ministri i Mjedisit që, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrë masat për paraqitjen e propozimit për miratimin e strukturës e të organikës së ISHMP-së, sipas ligjit, të Kryeministrit.

2. Kryeinspektori i ISHMP-së, mbështetur nga njësitë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse të Ministrisë së Mjedisit dhe në përputhje me kërkesat specifike për arsimin e inspektorëve, të miratuara nga Inspektorati Qendror, miraton kërkesat specifike për çdo vend pune në ISHMP.

3. Nëpunësit që kryejnë funksionet e inspektimit të mjedisit dhe pyjeve, të cilët janë aktualisht të emëruar pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, mbeten në të njëjtat detyra pranë ISHMP-së, brenda numrit dhe pozicioneve të organikës së miratuar sipas urdhrit përkatës të Kryeministrit, ndërsa nëpunësit që kryejnë funksionet e inspektimit të ujërave, aktualisht të emëruar pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, transferohen pranë Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

4. Në çdo rast, kryerja e procedurave, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të këtij kreu, kryhet duke respektuar kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi nr. 46, datë 29.1.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”, të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë apo akt nënligjor, që vjen në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

6. Ngarkohet ministri i Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama